



A.nr.174/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-anëtar, me Rushit Kajtazi - në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.174/2026 të datës 16.02.2026 të parashtruar nga ankuesi B.A, kundër organit të punësimit Komuna e Klllokotit në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve në punë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.06.2026 mori këtë

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.174/2026, e datës 16.02.2026 e parashtruar nga ankuesi B.A, **anulohet** Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin B.A, për vitin 2025 i nxjerr nga Kryetari i Komunës së Klllokotit, ndërsa lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë.

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Klllokotit, që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin B.A, për vitin 2025.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, B.A, (tutje referuar vetëm ankuesi), me datën 16.02.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit të datës 28.01.2026 për vlerësimin e rezultateve në punë të bërë nga Kryetari i Komunës së Klllokotit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 07.03.2024, dhe me datë 23.04.2026 ka proceduar kërkesën për

përgjigje në ankesë tek Komuna e Klllokotit, ndërsa kjo e fundit me datë 20.05.2026, ka kthyer përgjigje në ankesë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën e parashtruar nga ankuesi drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 852/2026 të datës 16.02.2026; Kopjen e letërnjoftimit për ankuesin B.A; Ankesë e datës 02.02.2026, drejtuar Kryetarit të Komunës së Klllokotit; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë i datës 28.01.2026; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë i datës 23.01.2023; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë i datës 26.02.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 07.03.2026, dërguar nga R.K, për N.R; Ripërtëritje e përgjigjes në ankesë e datës 23.04.2026, dërguar nga R.K, për N.R; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 174/2026, e datës 20.05.2026, Akt Emërimit e datës 19.07.2016, për ankuesin 19.07.2016.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se ankesa është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Klllokotit, sipas Akt Emërimit me numër protokolli 7554/1 të datës 19.07.2016, në pozitën “Zyrtar i Prokurimit”, në Komunën e Klllokotit.

Më tej nga shkresat lëndës Kolegji ka gjetur së Kryetari i Komunës së Klllokotit, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankuesit, me datë 28.01.2026, i ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2025, lidhur me vlerësimin e përgjithshëm e ka vlerësuar me notën e përgjithshme **1**.

Ankuesi B.A, i pakënaqur me vlerësimin e bërë nga Kryetari i Komunës së Klllokotit, me datë 16.02.2026, parashtron ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore përkundrazi në disa pjesë të formularit ekzistojnë kundërthënie të qarta ku në komente përshkruhet angazhim profesional, përpikëri dhe përfundim i detyrave brenda afateve, ndërsa nota finale është minimale 1 dobët gjë që e bënë vlerësimin e paarsyeshëm dhe arbitrar, dhe se ky vlerësim nuk mundet të shkapëtet nga rrethanat e mëparshme, pasi që i nijeti Kryetar Komune gjatë mandatit të kaluar me ka larguar nga puna pa asnjë arsye ligjore, vendim i cili është rrëzuar përmes procedurave ankimore, dhe se unë jam kthyer në vendin punës dhe se kjo tregon vazhdimësi të veprimeve tendencioze të cilat krijojnë dyshime të bazuar se vlerësimi aktual është i motivuar politikisht, me tej ankuesi pretendon që Këshilli t’i aprovoje ankesën e ankuesit si të bazuar në Ligj, duke anuluar vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2025, të nxjerr nga Kryetari i Komunës së Klllokotit.

Nga shkresat e lëndës del së Kryetari i Komunës së Klllokotit, me datën 28.01.2026 ankuesit i ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2025, duke e vlerësuar me notën e përgjithshme 1. Kolegji i Këshillit, pasi që ka analizuar formularin për vlerësimin e rezultateve për ankuesin për vitin 2025, duke e vlerësuar me notën e përgjithshme 1, ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Klllokotit, për vitin 2025, në rastin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin, ka vepruar në kundërshtim me Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë.

Bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se vlerësimin i rezultateve në punë për ankuesin është bërë në kundërshtim me nenin 15, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, ku përcaktohet se; 1. *Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohen: 1.1. Rregullorja Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publikë*, prandaj Kolegji i Këshillit konstaton se Kryetari i Komunës së Klllokotit, vlerësimin e rezultateve në punë nuk e ka bërë ashtu siç e përcaktojnë dispozitat e lartcekura që kanë qenë në fuqi, gjegjësisht sipas Rregullores Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë.

Kolegji i Këshillit, konstaton se Kryetari i Komunës së Klllokotit, lidhur me çështjen juridike është i obliguar që të beje rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin B.A, dhe të veprojë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik gjegjësisht neni 52 paragrafi 1,2,3 nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.3 si dhe paragrafit 4,5,6 nën paragrafit 6.1,6.2 dhe paragrafit 11 ku përcaktohet se “*Vlerësimi i rezultateve në punë 1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunës/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësi të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të paracaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunës/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i paracaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin*, prandaj bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Kolegji i Këshillit konstaton se Kryetari i Komunës së Klllokotit, është i obliguar që në bazë të dispozitave ligjore në fuqi të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin, B.A, sepse sipas arsytimit të këtij vendim Kolegji i Këshillit konstaton se lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2025, ka pasur shkeljeje të dispozitave ligjore në fuqi, sepse ankuesit nuk i janë hartuar objektivat e punës dhe si rrjedhojë Kolegji nuk e ka të qartë se si ka qenë e mundur që ankuesi të vlerësohet negativisht pa pasur objektiva të matshme.

Nga shqyrtimi i të gjitha fakteve dhe konstatimit të gjendjes faktike dhe juridike, sa i përket ankesës së ankuesit dhe provave të vërtetuar nga ankuesi dhe organi i punësimit, Kolegji i Këshillit vendosi që të aprovoj ankesën si të bazuar, të shfuqizoj Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin B.A, për vitin 2025, i nxjerr nga Kryetari i Komunës së Klllokotit, ndërsa lënda kthehet në rishqyrtim dhe

rivendosje të organi i njëjtë, që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin B.A, për vitin 2025.

Nisur nga konstatimet si me lartë. Kolegji i Këshillit konstaton së organi i punësimit Komuna e Klllokotit, përkatësisht Kryetari i Komunës së Klllokotit, pas pranimit të vendimit të Këshillit është i obliguar që të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin B.A, për vitin 2025, duke vepruar në pajtim me Ligjin nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.174/2026

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, B.A;
- Kryetarit të Komunës së Klllokotit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Klllokotit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.